



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:905298
Datë: 17.08.2021
Numri i dokumentit: 02092647

Ac.nr.1687/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi -kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, me zyrtaren ligjore Biondina Zeneli, në çështjen juridike -kontestimore të paditësve F.F.1. dhe F.F.2. nga Prishtina, të cilët i përfaqëson A.K., avokat nga Prishtina, rr. ”...”, nr...., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “C...” tani “D...” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim N.D., për kompensim dëmi, duke vendosur në lidhje me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3385/12 i datës 14.12.2017, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 04.08.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurës Kompania e Sigurimeve “D...” me seli në Prishtinë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3385/12 i datës 14.12.2017 në pikën I-rë të dispozitivit në pjesën që i referohet paditësit F.F.2. për kompensimin e dëmit material për automjet, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

II. REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurës Kompania e Sigurimeve “D...” në pikën e I-rë të dispozitivit në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit material dhe jo material për paditësin F.F.1., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.Nr.3385/12, VËRTETOHET

III. Pika II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit mbeten të pa shqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.3385/12 i datës 14.12.2017, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Miratohet pjesërisht kërkesëpadija e paditësit F.F.1. nga Prishtina, Miratohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit F.F.1. nga Prishtina, ashtu që detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “C...” tani “D...” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material dhe jo material paditësve t’ ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 10,335.50 euro, për paditësin F.F.1., shumën prej 5,400 euro dhe për paditësin F.F.2. shumën prej 4,935.50 me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destimin të caktuar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagimin definitiv, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit dhe atë: për paditësin F.F.1.: -në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 1,300.00 euro, -në emër të frikës, shumën prej 1,300.00 euro, -në emër të shëmtimit, shumën prej 2,500.00 euro; në emër të dëmit material: -në emër të ndihmës së personit të tretë, shumën prej 200.00 euro, -në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 100.00 euro, ndërsa për paditësin F.F.2., në emër të dëmit material: -për riparimin e automjetit të dëmtuar SMART CDI, shumën prej 4,935.50 euro. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur: Refuzohet pjesa e kërkesëpadijsë së paditësit F.F.1., në emër të kompensimit të dëmit jo material nga shuma e kërkuar dhe atë në emër të kompensimit për dhimbjet fizike, refuzohet shuma prej 2,700.00 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 3,700 euro, në emër të shëmtimit, shuma prej 7,500.00 euro, ndërsa në emër të dëmit material nga shuma e kërkuar dhe në emër të ndihmës së personit të tretë refuzohet shuma prej 600.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shuma prej 900.00 euro si dhe në emër të rehabilitimit klimaterik –fizioterapeutik shuma prej 500.00 euro, po ashtu refuzohet edhe kërkesëpadija e paditësit F.F.2. në emër të dëmit material për riparimin e automjetit të dëmtuar SMART CDI, shumën prej 954.50 euro si e pa bazuar. Në pikën III ka vendosur që: Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “C...” tani “D...” me seli në Prishtinë, që paditësve F.F.1. dhe F.F.2. nga Prishtina, në emër të shpenzimeve procedurale, t’ ia kompensoj shumën prej 1,904.00 euro në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuar i të paditurit brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovoj si të bazuar ankesën ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë ta prish ose ta ndryshoj duke zbritur shumat e gjykuara deri në vlerën e ofruar nga e paditura gjatë shqyrtimit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 27.12.2012, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit, me arsye si në padi

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3385/12, i datës 14.12.2017, me të cilin ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadijinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Gjykata pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat e administruara që i referohen natyrës dhe pasojave të lëndimeve të pësuar nga paditësit si pasojë e aksidentit e duke marrë për bazë mendimin e ekspertëve

mjeko-ligjor lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jo material gjykata vendosi në kuptim të nenit 200 të LMD-së. Me këtë rast, gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jete satisfaksion për të dëmtuarit-paditësit, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësve. Gjykata pasi konstatoj rrethanat e rastit duke pasur parasysh, natyrën e lehtë të lëndimit, sidomos sa i përket natyrës (dhe kohëzgjatjes së dhimbjeve dhe intensitetin e frikës të paditësi F.F.1., e duke i marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit sidomos moshën e tij, praktikën e mirë gjyqësore, (që i referohet lartësisë së kompensimit), vendosi si në diapozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar.

Vlerësimi i gjykatës për këto kategori dëmi i referohet vlerësimin specifik që i ka bërë gjykata secilës kërkesë të paditësve duke u mbështetur në ekspertizën mjekësore dhe atë sa i përket kohëzgjatjes dhe intensitetit të dhimbjeve fizike si dhe intensiteti dhe mënyrës së si është manifestuar frika tek paditësit pas aksidentit. Gjykata thekson se sa i përket shëmtimit trupor, dëmi i shkaktuar nuk ishte kontestues, ndërsa sa i përket shkallës së tij dhe lartësisë së kompensimi, bazuar në konstatimet e eksperteve, moshës se të dëmtuarit paditësit, duke vlerësuar edhe pretendimet e përfaqësuesit të tij si të bazuara, se i njëjti është i moshës se re, i pamartuar, bazuar edhe në praktiken gjyqësore vendosi lidhur me shumën e aprovuar,

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material, gjegjësisht për dhimbjet fizike, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë dhe lartësia e kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit është e lartë dhe në kundërshtim me natyrën e lëndimeve, pasojat e lëndimeve dhe provat e administruara (mendimi i ekspertëve mjekësor). Sa i përket dëmit material – ndihmës dhe kujdesit nga personi i tretë dhe ushqimi i përforcuar, bazuar në vlerësimet e ekspertëve, ku të njëjtit kanë vlerësuar të nevojshme të njëjtat, si dhe praktikes gjyqësore, duke e vlerësuar si reale kërkesën e paditësit, vendosi lidhur me shumën e aprovuar, ndërsa sa i përket rehabilitimit klimaterik – fizioterapeutik, të njëjtën e refuzoi, pasi që e njëjta nuk provua me prova përkatëse- fatura. Sa i përket kërkesë së paditësit F.F.2. për kompensim dëmit material — për riparimin e automjetit, meqë baza e kërkesëpadisë nuk ishte kontestuese, gjykata për vlerësimin e lartësisë së dëmit, gjykata, mbi bazën e propozimit të ndërgjyqësve, kishte nxjerrë dy ekspertiza nga kjo lëmi, dhe atë Ekspertizat e Makinerisë (It. 06.04.2017 të punuar nga ing S.B., si dhe Ekspertizën e Makinerisë cit. 24.09.2017, të punuar nga ing G.M.. Eksperti S.B., kishte vlerësuar demin në automjetin e markës "SMART CDI" me targa në shumë prej 5,890.00€, ndërsa eksperti G.M. kishte vlerësuar demin në automjet në shumë prej 3,981.00€. Që të dy ekspertë kanë vlerësuar se automjeti ka dëme të mëdha materiale, kemi të bëjmë me dëme total të automjetit, ku riparimi i të njëjtit do të kushtonte me shumë se vlera e tij e mbetur. Gjykata konstaton se nuk është kontestuese dëmi i shkaktuar në automjetin e paditësit F.F.2. F., kontestuese mbetet lartësi e saj. Nisur nga fakti se kemi të bëjmë me çmim të varirueshem të automjeteve në treg, faktit se ekspertit me rastin e vlerësimin të vlerës se automjetit dhe të pjesëve të tij kanë përdorur katalogë të ndryshme, ku të njëjti edhe pas ballafaqimit nuk' arritën të një mendim i përbashkët të tyre, si dhe fakti se nuk' kishim një mendim grupor për vlerësim të kësaj çështje, gjykata bazuar në të lartcekurat vendosi që të merr mesataren e dy ekspertizave me rastin e aprovimit të kërkesës se paditësit F.F.2. sa i përket dëmit të shkaktuar në automjetin e markës "SMART CDI" me targa Bazuar në të lartcekurat gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesën e tij në shumën prej 4,935.50€, ndërsa u refuzua shuma prej 954,50€. Gjykata lidhur me këtë kërkesë ka vlerësuar të dy

ekspertizat, si dhe sqarimet e dhëna nga të dy ekspertet, por nuk gjeti që asnjëra nga të jetë me bindëse se tjetra, (Ika edhe nuk mundi që vendimin e saj ta bazoj ekskluzivisht në njërin nga to, andaj vendosi mbi bazën e arsyeve të lartcekura duke marr mesataren e çmimit të vlerësuar nga të dy ekspertët.

Për kamatën gjykata ka vendos duke u mbështetur në dispozitat e nenit 186 dhe 277 të LMD-së, Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e atakuar dhe duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë (pika I në pjesën që i referohet paditësit F.F.2.)) nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, e për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar në pikën I, të dispozitivit në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit material për riparimin e automjetit për paditësin F.F.2., është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Kjo pjesë e aktgjykimit është në kundërshtim me vetveten pasi në njërin pjesë thuhet se miratohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit F.F.2., duke u obliguar e paditura në kompensimin e dëmit në ;lartësi prej 4, 935.50 euro, ndërsa nga arsyetimi kuptohet se nuk është miratuar në tërësi por pjesërisht kërkesëpadia e paditësit në fjalë, pasi nga parashtesa mbi precizimin e datës 14 Dhjetor 2017, paditësi F.F.2. përmes të autorizuarit të tij av.A.K. ka kërkuar shumën prej 5,890 euro si kompensim i dëmit total.

Gjykata në raport me pikën I-të të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka nxjerrë dhe administruar dy ekspertiza të makinerisë dhe atë ekspertizën e ekspertit S.B. dhe ekspertizën e ekspertit G.M., madje edhe ka bërë ballafaqimin e këtyre ekspertëve e të cilët kanë dhënë mendime të ndryshme në raport me lartësinë. Përderisa eksperti S.B. ka vlerësuar se dëmi total të automjetit duhet të kompensohet në lartësi prej 5,890 euro, ndërsa eksperti G.M. kishte përcaktuar lartësinë e kompensimit 3,981.00 euro që është nja dallim i madh në mes të mendimeve të këtyre dy ekspertëve. Gjykata duke mos ia falur besimin asnjërit mendim vendos që të caktoj lartësinë prej 4,935.50 euro, pa dhënë arsye të qarta se ku e bazon një mendim të tillë, e i cili mendim është në kundërshtim me dy ekspertizat por i cili mendim argumentohet vetëm me nxjerrjen e një mesatareje në mes të dy mendimeve. Në rastin konkret vlerësimi i gjykatës ka qenë jo në përputhje me ligjin, pasi sipas nenit 356 të LPK-së citoi: “Gjykata, me propozimin e palëve mundë të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes”. Në rastin konkret nuk mund të ketë vlerësime të tilla nga ana e gjykatës pasi gjyqtarit i mungon dijenia profesionale, por gjyqtari i çështjes pas ballafaqimit të ekspertëve, nëse prapë ka pasur dilema se cilës ekspertizë t’ia fal besimin, apo çështja nuk është sqaruar sa duhet nga ana e ekspertëve, apo sqarimet nuk kanë qenë bindëse, është dashur që të caktojë një grup të ekspertëve për të dhënë mendimin përfundimtar profesional për këtë çështje, pasi vetëm në këtë mënyrë do ta rrihej të vërtetohej në mënyrë të plotë gjendja faktike. Si rezultat

i lëshimeve të gjykatës që kanë rezultuar me vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike, edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga ana e gjykatës.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar në raport me pikën e I-rë të dispozitivit që i referohet kompensimit të dëmit material dhe jo material për paditësin F.F.1. nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar (në raport me pikën e I-rë të dispozitivit që i referohet kompensimit të dëmit material dhe jo material për paditësin F.F.1.) është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese baza e kërkesëpadisë nga ana e të paditurës, pasi nga deklarimi në seancë i përfaqësuesit të palës së paditur nuk është kontestuar, pra nuk është kontestuar fakti se shkaktar i aksidentit ka qenë i siguruari i të paditurës.

Në raport me shumat e gjykuara sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit shumat në fjalë janë adekuate në raport me shkallën e lëndimeve, dhimbjet e shkaktuara si rezultat i lëndimeve dhe frikën e pësuar gjatë lëndimeve. Lartësia është në përputhje të plotë me praktikën gjyqësore, dhe shumat e gjykuara nuk paraqesin në asnjë mënyrë pasurim të pa bazë siç pretendohet nga e paditura, por paraqesin një satisfacion moral sikurse synohet me dispozita ligjore.

Nga ekspertiza mjekësore nga lëmia e ortopedisë e dhënë nga eksperti XH.S. është vërtetuar fakti se paditësi F.F.1. në aksidentin e datës 13.07.2012 ka pësuar këto lëndime: tej zgjatje të unazave të qafës, ndrydhje të unazave të belit, ndrydhje të komblikut, plagë prerëse dermishëse të shumta me gërvishje masive të pjesës kërbishtore dhe të të ndenjures së majtë, e të cilat lëndime janë klasifikuar si lëndime të lehta trupore. Lëndimet e cekura më lartë paditësit F.F.1. i kanë shkaktuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë rreth 30 minuta, të intensitetit të rëndë 24 orë, të mesëm 2 javë dhe të ulta deri në 1 vit. Lëndimet e pësuar kanë shkaktuar shëmtim të shkallës së mesme, ku paditësi ka pasur nevojë për ndihmë për kujdes nga personi i tretë për 2 javë, ushqim të përforcuar për 4 javë dhe rehabilitim klimaterik për 20 ditë. Ndërsa eksperti nga lëmia e psikiatrisë ka konstatuar se te paditësit F.1. është manifestuar frika primare e cila ka zgjatur për disa minuta, frika sekondare e intensitetit të lartë për 24 orë, të intensitetit mesatar për 6 muaj dhe të lehtë edhe sot. Pra nga lëndimet në fjalë që ka pësuar paditësi e si rezultat i të cilave ka pësuar dhimbje dhe frika e shfaqur, arsyetojnë në plotni shumat e gjykuara, dhe të cilat janë proporcionale me dhimbjen e pësuar, frikën e përjetuar dhe dhimbjen si pasojë e shëmtimit të shkaktuar.

Në rigjykim në raport me pikën e I-rë në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit material për automjetet për paditësin F.F.2., gjykata duhet të eliminojë shkeljet e e konstatuara nga ana e kësaj gjykate, të vërtetojë saktë dhe mënyrë të plotë gjendjen faktike, meqenëse nuk ua ka falur besimin asnjërit mendim të ekspertëve të makinerisë të nxjerrët provë e re nga lëmia e makinerisë përmes grupit të ekspertëve, ndërsa me rastin e hartimit të aktgjykimit të ketë parasysht elementet e kërkuar ligjore nga neni 160 i LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) dhe pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2020:905298
Datë: 17.08.2021
Numri i dokumentit: 02092647

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1438/17, me datë 04.08.2021

Kryetari i kolegjit
Faton Ademi, d.v